

Nr. 1499 Prot.

Tiranë, më 02.07.2026

UDHËZIM¹

Nr. 2, datë 02.07.2026

**PËR
ZHVILLIMIN, PRODHIMIN DHE SHPËRNDARJEN E STATISTIKAVE TË
BIZNESIT BAZUAR NË RREGULLOREN (BE) 2019/2152 E PARLAMENTIT
EVROPIAN DHE KËSHILLIT**

Bazuar në nenet 17/4 dhe 20/b të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, ligjin nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022–2026”, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, miratuar me vendimin nr.16, datë 11.01.2024, si dhe vendimin nr. 16, datë 30.06.2026 të Dordit Drejtues të Institutit të Statistikave,

UDHËZOJ:

1. Statistikat e biznesit zhvillohen, prodhohen dhe shpërndahen bazuar në këtë udhëzim, i cili përaftron Rregulloren (BE) 2019/2152 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.
2. Ky udhëzim mbi Statistikat e Biznesit vendos një kornizë të unifikuar për këto statistika, duke integruar dhe harmonizuar prodhimin e statistikave mbi ndërmarrjet, aktivitetet ekonomike, tregtinë, inovacionin, kërkim-zhvillimin dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Për përshtatjen e tij në statistikat zyrtare të Shqipërisë, fokusi është në forcimin e sistemit të regjistrave statistikorë të biznesit si burim kryesor, përdorimin e të dhënave administrative për të ulur barrën e raportimit për ndërmarrjet sidomos ndërmarrjet mikro të vogla dhe të mesme, (NMVM-të), standardizimin e metodologjive dhe klasifikimeve sipas praktikave të Bashkimit Evropian (BE-së), si dhe rritjen e integritetit të proceseve statistikore përmes përdorimit të të dhënave të ndërlidhura dhe shkëmbimit të të dhënave mikro aty ku është e nevojshme dhe e lejueshme. Gjithashtu, ky udhëzim synon përmirësimin e cilësisë, krahasueshmërisë dhe afateve të prodhimit të statistikave të biznesit, duke siguruar përafrim me standardet ndërkombëtare dhe nevojat e politikave publike për zhvillim ekonomik, digjitalizim dhe inovacion.
3. Udhëzimi sjell përmirësime thelbësore në prodhimin e statistikave të biznesit, duke synuar uljen e barrës për ofruesit e të dhënave, rritjen e fleksibilitetit dhe përmirësimin e aftësisë për t’iu përgjigjur kërkesave të reja të përdoruesve dhe politikëbërësve. Ky udhëzim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt një sistemi më të integruar, koherent dhe efikas të statistikave të biznesit në BE-së.
4. Udhëzimi për Statistikat e Biznesit siguron:

¹ Ky udhëzim përaftron pjesërisht Rregulloren (BE) 2019/2152 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi statistikën e biznesit (EBS), CELEX 32019R2152



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- a. Krijimin e konsistencës dhe integritetit, nëpërmjet:
- garantimit të konsistencës metodologjike ndërmjet fushave të statistikave të biznesit (p.sh. variablave statistikore, regjistrave dhe rregullave të konfidencialitetit);
 - integritetit të anketave të ndryshme të biznesit në nivel kombëtar, duke ulur barrën e përgjithshme të raportimit.
- b. Përdorimin e përkufizimeve të përbashkëta dhe përmirësimin e krahasueshmërisë së statistikave;
- c. Harmonizimin e klasifikimit të bizneseve sipas madhësisë së punësimit.

5. Ky udhëzim mbështet përdorimin e metodave inovative dhe burimeve të reja të të dhënave, përfshirë lidhjen e të dhënave ndërmjet fushave statistikore dhe shkëmbimin e të dhënave mikro. Lidhja e të dhënave përmirëson cilësinë statistikore me kosto të ulët.

6. Ulja e barrës për ofruesit e të dhënave, nëpërmjet harmonizimit ligjor dhe metodologjik, redukton mbivendosjet dhe dyfishimet në mbledhjen e të dhënave. Anketat mund të përdoren për disa fusha statistikore njëkohësisht, duke ulur kostot për INSTAT dhe barrën raportuese për bizneset.

7. Objekti

Ky udhëzim përcakton:

- a) zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave të biznesit, siç parashikohet në pikën 8/1;
- b) kuadrin për regjistrat statistikorë të biznesit.

8. Qëllimi

1. Statistikat e biznesit do të mbulojnë:
 - a) strukturën, aktivitetet ekonomike dhe performancën e njësive statistikore, aktivitetet e tyre të kërkim zhvillimit dhe inovacionit, përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe tregtinë elektronike. Për qëllimet e këtij udhëzimi, statistikat e biznesit do të mbulojnë gjithashtu statistikat e kërkim zhvillimit në sektorin e arsimit të lartë, institucionet qeveritare dhe sektorin privat jofitimprurës;
 - b) prodhimin e mallrave dhe tregtinë ndërkombëtare të mallrave.
2. Kuadri kombëtar do të mbulojë regjistrat kombëtarë statistikorë të biznesit.
3. Regjistrat kombëtarë statistikorë të biznesit të përmendur në pikën 2 do të përfshijnë:
 - a) të gjitha ndërmarrjet që kryejnë aktivitete ekonomike që kontribuojnë në produktin e brendshëm bruto (PBB), dhe njësitë e tyre lokale;
 - b) njësitë ligjore nga të cilat përbëhen ato ndërmarrje;

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë,
Tel. +355 (4) 2222222 / 2222222 / 2222222 / 2222222

- c) për ato ndërmarrje që kanë një ndikim të rëndësishëm për shkak të madhësisë së tyre dhe njësitë e tyre sipas llojit të aktivitetit (KAU) kanë gjithashtu një ndikim të rëndësishëm në të dhënat e agreguara (kombëtare) ose:
- KAU dhe madhësia e secilit KAU nga të cilat përbëhen ato ndërmarrje; ose
 - kodi i aktiviteteve dytësore të atyre ndërmarrjeve sipas Nomenklaturës së veprimtarive ekonomike (NVE) dhe madhësia e secilës prej këtyre aktiviteteve dytësore;
- d) grupet e ndërmarrjeve të cilave u përkasin ato ndërmarrje.
4. Familjet nuk do të përfshihen në kuadrin kombëtar për regjistrat statistikorë të biznesit për atë sa mallrat dhe shërbimet që ato prodhojnë janë të destinuara për konsum të tyre, ose përfshijnë dhënien me qira të pronës së tyre.
5. Kur i referohet regjistrave kombëtarë statistikorë të biznesit, ky udhëzim do të zbatohet vetëm për njësitë që, plotësisht ose pjesërisht, ushtrojnë një aktivitet ekonomik dhe për njësitë ligjore joaktive, të cilat janë pjesë e një ndërmarrjeje në kombinim me njësitë ligjore aktive.
6. Për qëllimet e kuadrit kombëtar për regjistrat statistikorë të biznesit, do të konsiderohet si aktivitet ekonomik:
- a) çdo aktivitet që përfshin ofrimin e mallrave dhe shërbimeve në një treg të caktuar;
 - b) shërbime jo-tregtare që kontribuojnë në PBB;
 - c) mbajtja direkte dhe indirekte e njësive ligjore aktive.
- Mbajtja e aktiveve dhe/ose detyrimeve mund të konsiderohet gjithashtu si një aktivitet ekonomik.
7. Njësitë statistikore brenda kuadrit për regjistrat statistikorë të biznesit do të përcaktohen në përputhje me Ligjin nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, subjekt i kufizimeve të specifikuara në këtë pike.

9. Përkufizime

Për qëllimet e këtij udhëzimi, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- a) “njësi statistikore” nënkupton njësitë statistikore në kuptimin e Ligjit nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”;
- b) “njësi raportuese” nënkupton njësinë që furnizon me të dhëna;
- c) “fushë” nënkupton një ose disa grupe të dhënash që mbulojnë tema të veçanta;
- d) “temë” nënkupton përmbajtjen e informacionit që do të përpilohet, secila temë mbulon një ose më shumë tema të detajuara;
- e) “temë e detajuar” nënkupton përmbajtjen e detajuar të informacionit që do të përpilohet në lidhje me një temë, secila temë e detajuar mbulon një ose më shumë variabla;
- f) “variabël” nënkupton një karakteristikë të një njësie që mund të përfaqësojë një ose më

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- shumë se një nga një grup vlerash;
- g) “aktivitet tregu” nënkupton një aktivitet tregtar kur mallrat dhe shërbimet përkatëse tregtohen në kushtet e mëposhtme:
- i. shitësit veprojnë për të maksimizuar fitimet e tyre në afat të gjatë dhe e bëjnë këtë duke shitur mallra dhe shërbime lirisht në treg kujtdo që është i gatshëm të paguajë çmimin e kërkuar;
 - ii. blerësit veprojnë për të maksimizuar dobishmërinë e tyre duke pasur parasysh burimet e kufizuara që disponojnë, duke blerë sipas produkteve që plotësojnë më mirë nevojat e tyre me çmimin e ofruar;
 - iii. ekzistojnë tregje efektive ku shitësit dhe blerësit kanë akses dhe informacion mbi tregun. Një treg efektiv mund të funksionojë edhe nëse këto kushte nuk përmbushen në mënyrë të përsosur.
- h) “Aktivitet jo-tregu” nënkupton një aktivitet në të cilin mallrat dhe shërbimet nuk tregtohen në kushte tregu, pra kur shitësit nuk veprojnë me synim maksimizimin e fitimit në afatgjatë përmes shitjes së lirë në treg, kur çmimet nuk përcaktohen nga mekanizmat e tregut dhe kur nuk ekzistojnë kushte të një tregu efektiv me akses dhe informacion të plotë për blerësit dhe shitësit. Për rrjedhojë, një entitet i kontrolluar nga qeveria që ushtron aktivitet jo-tregu klasifikohet në sektorin e qeverisë dhe deficitit apo borxhi i tij përfshihet në deficitin dhe borxhin e qeverisë;
- i) “prodhues tregu” nënkupton NJVA-të lokale (KAU) ose njësitë institucionale, pjesa më e madhe e prodhimit të të cilave është prodhim tregtar, pra mallra dhe shërbime që tregtohen në kushte tregu, ku shitësit veprojnë me synim maksimizimin e fitimit në afatgjatë dhe blerësit i blejnë ato sipas nevojave dhe çmimeve të ofruara në një treg efektiv;
- j) “prodhues jo-tregu” nënkupton NJVA-të lokale (KAU) ose njësitë institucionale, pjesa më e madhe e prodhimit të të cilave ofrohet falas ose me çmime që nuk janë ekonomikisht domethënëse;
- k) “INSTAT” është institucioni përgjegjës për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave kombëtare të biznesit.
- l) “INSTAT” është ofruesi i vetëm i të dhënave që përmbajnë regjistrin kombëtar statistikor të biznesit në përputhje me standardet e cilësisë të përmendura në nenin 17;
- m) “të dhëna mikro” nënkupton vëzhgimet ose matjet individuale të karakteristikave të njësive raportuese të identifikueshme ose njësive statistikore;
- n) “përdorim për qëllime statistikore” nënkupton përdorimin për qëllime të prodhimit të statistikave zyrtare siç përcaktohet në nenin 14 të Ligjit nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”;
- o) “të dhëna konfidenciale” nënkupton të dhëna konfidenciale siç përcaktohet në Ligjin nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, si dhe ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- p) “administrata tatimore” nënkupton autoritetet kombëtare në Shqipëri përgjegjës për zbatimin e ligjit nr. 9920, 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e

Shqipërisë”, i ndryshuar;

- q) “administrata doganore” nënkupton autoritetet doganore në Shqipëri siç përcaktohet në ligjin Nr. 102/2014 “Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- r) “eksportet” nënkuptojnë mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, të përpunimit pasiv, të rieksporuara për t’ju nënshtruar përpunimit aktiv.
- s) “importet” nënkuptojnë mallra që vijnë nga një vend i tretë dhe të vendosura direkt në magazinat e ruajtjes, nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.
- t) “mallra” nënkupton prona të lëvizshme, duke përfshirë energjinë elektrike dhe gazin natyror.

10. Burimi i të dhënave dhe metodat

INSTAT do të prodhojë statistikat e përmendura në pikat 12 dhe 13 si dhe do të krijojë regjistrat e tij kombëtarë statistikorë të biznesit, duke përdorur çdo burim të rëndësishëm të të dhënave duke shmangur ngarkesën e tepruar mbi të anketuarit dhe duke marrë parasysh efektivitetin e kostos së institucionit.

Për prodhimin e statistikave dhe regjistrave kombëtarë statistikorë të biznesit të kërkuar sipas këtij udhëzimi, dhe me kusht që rezultatet të përputhen me kriteret e cilësisë të përmendura në pikën 14, INSTAT mund të përdorë burimet e mëposhtme të të dhënave, duke përfshirë një kombinim të tyre:

- a) vrojtme;
- b) të dhëna administrative, duke përfshirë informacionin nga administrata tatimore dhe doganore;
- c) çdo burim tjetër i rëndësishëm, metoda ose qasje inovative për aq sa lejojnë prodhimin e të dhënave që janë të krahasueshme dhe në përputhje me kërkesat specifike të cilësisë.

Për vrojtmet, siç përmendet në pikën (a) njësitë statistikore të pyetura nga INSTAT do të ofrojnë informacion të saktë, të plotë dhe në kohë, të nevojshëm për prodhimin e statistikave dhe regjistrave kombëtarë statistikorë të biznesit të kërkuar sipas këtij udhëzimi.

Metodat dhe qasjet e përmendura në pikën (c) do të jenë të bazuara në studime dhe të dokumentuara.

11. Aksesimi në të dhënat administrative dhe ofrimi i informacionit

1. Në përputhje me nenin 33 të Ligjit nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” INSTAT ka të drejtën të ketë qasje të përdorë, menjëherë dhe pa pagesë, të gjitha regjistrat administrativë dhe t’i integrojë ato regjistra me burime të tjera të të dhënave për të përmbushur kërkesat statistikore sipas këtij udhëzimi dhe për të përditësuar regjistrat kombëtarë statistikorë të biznesit. Qasja

në ato regjistra nga INSTAT, do të kufizohet në regjistrat administrativë brenda sistemeve të tyre përkatëse publike administrative.

2. Administrata doganore, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave do t'i ofrojë INSTAT informacion për qëllime statistikore të lidhura me eksportet dhe importet e mallrave siç specifikohet në Aneksin IV.

12. Aktivitetet statistikore

1. Statistikat e biznesit do të mbulojnë fushat e mëposhtme:

- a. statistikat afatshkurtra të biznesit;
- b. statistikat e biznesit në nivel vendi;
- c. statistikat rajonale të biznesit;
- d. statistikat mbi aktivitetet ndërkombëtare.

2. Fushat do të përfshijnë një ose më shumë nga temat e mëposhtme siç janë detajuar më tej në Aneksin I:

- a. numri i bizneseve;
- b. përdorimi i TIK dhe tregtia elektronike;
- c. inovacioni;
- d. tregtia ndërkombëtare e mallrave;
- e. investimet;
- f. kosto e punës;
- g. rezultatet dhe performanca
- h. çmimet;
- i. blerjet;
- j. pasuritë e paluajtshme;
- k. të dhënat e kërkimit dhe zhvillimit.

3. Periodiciteti, periudha e referencës dhe njësia statistikore e secilës temë do të jenë siç specifikohet në Aneksin II.

13. Specifikimet teknike për kërkesat e të dhënave

1. Për temat e detajuara të listuara në Aneksin I, INSTAT duhet të përpilojë të dhëna të rëndësishme për secilën temë të detajuar sipas përkufizimeve të tyre teknike.

- a. variablat;
- b. njësia e matjes;
- c. popullata statistikore (përfshirë kërkesat në terma të aktiviteteve të tregut/jo- të tregut ose prodhuesve);
- d. klasifikimet (përfshirë produktin, vendet dhe territoret si dhe natyrën e listave të

- transaksioneve) dhe ndarjet;
- e. transmetimi i të dhënave individuale në baza vullnetare;
 - f. përdorimi i përafrimeve dhe kërkesave të cilësisë;
 - g. afati i transmetimit të të dhënave;
 - h. periudha e parë e referencës;
 - i. peshimi dhe ndryshimi i vitit bazë për fushën e statistikave të afatshkurtra të biznesit;
 - j. specifikime të mëtejshme, përfshirë periudhën e referencës, të lidhura me temën e tregtisë ndërkombëtare të mallrave.

14. Cilësia

1. INSTAT duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar cilësinë e statistikave të biznesit të prodhuara dhe të transmetuara si dhe të regjistrave kombëtarë statistikorë të biznesit, të cilat do të vlerësohen nga Eurostat.

INSTAT do t'i transmetojë çdo vit Komisionit (Eurostat):

- a. raporte cilësie dhe metadata për të dhënat e transmetuara sipas këtij udhëzimi;
- b. raporte cilësie dhe metadata të lidhura me regjistrat kombëtarë statistikorë të biznesit.

Në rastin e statistikave shumëvjeçare (që zhvillohen një herë në disa vite), periodiciteti i raporteve të cilësisë dhe metadatave të përmendura në pikën (a) të nënparagrafit të parë do të jetë i njëjtë me atë të statistikave të prodhuara.

2. INSTAT do të informojë Komisionin (Eurostat) sa më shpejt të jetë e mundur për çdo informacion ose ndryshim të rëndësishëm në lidhje me zbatimin e këtij udhëzimi që do të ndikonte në cilësinë e të dhënave të transmetuara. INSTAT do të informojnë Komisionin (Eurostat) për ndryshime metodologjike ose të tjera të mëdha që ndikojnë në cilësinë e regjistrave kombëtarë statistikorë të biznesit. Informacioni do të jepet sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të çdo ndryshimi të tillë.

3. Pas një kërkesë të arsyetuar nga Komisioni (Eurostat), INSTAT do të ofrojë informacionin shtesë të nevojshëm për të vlerësuar cilësinë e informacionit statistikor, i cili nuk do të krijojë një kosto ose barrë të konsiderueshme shtesë për INSTAT ose për të anketuarit.

15. Transmetimi i të dhënave dhe metadatave

INSTAT do t'i ofrojë Komisionit (Eurostat) të dhënat dhe metadatat e kërkuara nga ky udhëzim në përputhje me standardet e shkëmbimit të të dhënave dhe metadatave. Kur të dhënat e transmetuara janë konfidenciale, ato do të dërgohen me një shënim që tregon se është subjekt i konfidencialitetit dhe nuk mund të shpërndahen.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Pas një kërkesë të arsyetuar nga Komisioni (Eurostat), INSTAT do të kryejë analiza statistikore të regjistrave kombëtarë statistikorë të biznesit dhe do të transmetojë rezultatet Komisionit (Eurostat).

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Lantona Sado





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Aneks I: Temat

Domain 1. Statistikat Afatshkurtra

Tema	Temat e detajuara
Numri i ndërmarrjeve	Ngjarjet demografike të ndërmarrjeve
Treguesit e forcave të punës	Punësimi
	Orët e punës
	Kosto e punës
Çmimet	Çmimet e importit
	Çmimet e prodhimit
Rezultatet dhe Performanca	Prodhiimi
	Volumi i shitjeve neto
	Shitjet Neto
Aktivitetet e pasurive të paluajtshme	Aktivitetet e pasurive të paluajtshme

Domain 2. Statistikat e ndërmarrjeve në nivel vendi

Tema	Temat e detajuara
Numri i ndërmarrjeve	Numri i ndërmarrjeve aktive
	Ngjarjet demografike të ndërmarrjeve (të reja, të mbyllura, të mbijetuara)
	Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta

**INSTITUTI I STATISTIKAVE**

Tel: +355 (4) 3333350 / 3333444 / 3333373 / 3333377 / 3333378



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

	Shpenzime për të mira dhe shërbime në ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta
	Importi i ndërmarrjeve
Rezultatet dhe Performanca	Shitjet Neto
	Marzhi tregtar
	Prodhimi
	Vlera e shtuar
	Teprica bruto operative
	Shitje Neto në ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta
	Vlera e prodhimit në ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta
	Vlera e shtuar në ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta
	Shitjet Neto në ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta dhe filialet vendase
	Prodhimi industrial
	Eksporti i ndërmarrjeve
Investimet	Investime gjithsej
	Investime gjithsej nga ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta
Inovacioni	Inovacioni
Përdorimi i TI-së dhe tregtia online	Përdorimi i TI-së dhe tregtia online



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Domain 3. Statistikat rajonale të ndërmarrjeve, (NUTS II)

Tema	Temat e detajuara
Numri i ndërmarrjeve	Numri i ndërmarrjeve sipas rajoneve
	Ngjarjet demografike të ndërmarrjeve sipas rajoneve (të reja, të mbyllura, të mbijetuara)
Treguesit e forcave të punës	Punësimi sipas rajoneve
	Punësimi lidhur me ngjarjet demografike të ndërmarrjeve sipas rajoneve (të reja, të mbyllura, të mbijetuara)
	Kosto e punës sipas rajoneve
Treguesit e Kërkim Zhvillimit	Shpenzimet në Kërkim Zhvillim sipas rajoneve
	Punësimi në Kërkim Zhvillim sipas rajoneve

Domain 4. Statistikat e tregtisë së jashtme

Tema	Temat e detajuara
Tregtia e jashtme e mallrave	Tregtia e jashtme e mallrave

REPublika e Shqipërisë
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Aneks II: Frekuenca, Periudha e referencës, Njësia statistikore

Domain 1. Statistikat Afatshkurtra

Tema	Frekuenca	Periudha e referencës	Njësia statistikore
Numri i ndërmarrjeve	tremujore	tremujori	njësia ligjore
Treguesit e forcave të punës	tremujore(mujore opsionale)	tremujori (muaji opsionale)	KAU
Çmimet	tremujore	muaji me përjashtimet e mëposhtme -- çmimet e prodhimit për ndërtesat	Ndërmarrja
Rezultatet dhe Performanca	mujore me përjashtimet e mëposhtme – vendet e vogla për Seksionin F të NVE-së: tremujore (mujore opsionale)	muaji me përjashtimet e mëposhtme – vendet e vogla për seksionin F tek NVE: tremujore (mujore opsionale)	KAU
	mujore;tremujore për vendet e vogla për Seksionin F te NVE-së.		
Aktivitetet e pasurive të paluajtshme	tremujore (mujore opsionale)	tremujori (muaji opsionale)	nuk zbatohet

Domain 2.Statistikat e ndërmarrjeve në nivel vendi

 REPUBLIKA E SHQIPËRISE
 INSTITUTI I STATISTIKAVE

Tema	Frekuenca	Periudha e referencës	Njësia statistikore
Numri i ndërmarrjeve	vjetore	viti kalendarik	ndërmarrja
Kosto e punës	vjetore	viti kalendarik	ndërmarrja
Treguesit e Kërkim & Zhvillimit	çdo dy vite me përjashtimet e mëposhtme – Ndarja sipas sektorëve të performancës të shpenzimeve të K&ZH të brendshëm, personeli dhe numri i kërkuesve shkencor për K&ZH, si dhe fondet e alokuara nga buxheti i shtetit për K&ZH (GBARD) dhe fondet publike të orientuar ndërkombtarisht: vjetore	viti kalendarik	Ndërmarrja; Institucionet e arsimit të lartë; Institucionet shtetërore dhe OJF-të.

REPUBLICA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Shpenzimet	vjetore me përjashtimin e mëposhtëm — pagesa për nënkontraktor: çdo tre vite	viti kalendarik	ndërmarrja
Rezultatet dhe Performanca	vjetore me përjashtimet e mëposhtme — Shitjet neto të detajuara sipas produktit dhe vendbanimit të klientit për NVE 69.1, 69.2, 70.2, 71.1, 71.2 and 73.2: çdo dy vite — Shitjet neto nga bujqësia, pyjet, peshkimi dhe aktivitetet industriale, shitjet neto nga aktivitetet industriale, shitjet neto nga aktivitetet industriale pa përfshirë ndërtimin, shitjet neto nga ndërtimi, shitjet neto nga aktivitetet e shërbimeve, shitjet neto nga aktivitetet tregtare të blerjes dhe ri-shitjes dhe nga aktivitetet ndërmjetëse, shitjet neto nga ndërtimi dhe shitjet neto nga inxhinieria civile: çdo pesë vite — të ardhurat nga marrëveshjet nënkontraktore: çdo	viti kalendarik	ndërmarrja me përjashtimet e mëposhtme —prodhimi i shitur, prodhimi bazuar në marrëveshjet nënkontraktore dhe prodhimi gjithsej: KAU

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë,

 REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 INSTITUTI I STATISTIKAVE

	tre vite		
Investimet	vjetore me përjashtimin e mëposhtëm – investime të patrupëzuara: çdo tre vite	viti kalendarik	ndërmarrja
Inovacion	çdo dy vite	Periudha e referencës është periudha trevjeçare para përfundimit të çdo viti kalendarik çift	ndërmarrja
Përdorimi i TI-së dhe tregtia online	vjetore	Viti kalendarik i miratimit të rregullores së implementimit që përcakton variablat; viti kalendarik pasues vitit të miratimit të rregullores së implementimit që përcakton variablat për variablat e tjerë. (shitjete neto)	ndërmarrja

Domain 3. Statistikat rajonale të ndërmarrjeve

Tema	Frekuenca	Periudha	Njësia statistikore
------	-----------	----------	---------------------

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë,

 REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 INSTITUTI I STATISTIKAVE

		e referencës	
Numri i ndërmarrjeve	vjetore	viti kalendarik	ndërmarrja me përjashtimin e mëposhtëm – numri i njësive lokale (opsionale për Sesionin K të NVE-së): njësia lokale
Treguesit e forcave të punës	vjetore	viti kalendarik	ndërmarrja me përjashtimet e mëposhtme– numri i të punësuarve dhe të vetëpunësuarve në njësitë lokale, paga në njësitë lokale: njësia lokale
Treguesit e Kërkim Zhvillimit	çdo dy vite	viti kalendarik	Ndërmarrja; Institucionet e arsimit të lartë; Institucionet shtetërore dhe OJF-të.

Domain 4. Statistikat e tregtisë së jashtme

Tema	Frekuenca	Periudha e referencës	Njësia statistikore
Tregtia e jashtme e mallrave	mujore me përjashtimin e mëposhtëm – çdo dy vite shpërndarja sipas nomenklaturës së kombinuar të mallrave dhe monedhës së faturimit të tregtisë së jashtme të mallrave për importin dhe eksportin	muaji	nuk zbatohet

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë,
 Tel: +355 (4) 2222250 / 2222251 / 2222252

Aneks III: Elementët e kuadrit kombëtar për regjistrat statistikore të bizneseve

Pjesa A: Temat e detajuara të regjstrit

1. Njësitë e listuara në regjistrat kombëtarë statistikore të bizneseve , siç i referohet Neni 2 i kësaj rregulloreje, do të karakterizohen me një numër identifikimi dhe me temat e detajuara të regjstrit të specifikuara në Pjesën C.
2. Njësitë e listuara në regjistrat kombëtarë statistikore të ndërmarrjeve do të identifikohen në mënyrë unike me një numër identifikimi për të lehtësuar rolin e infrastrukturës së kuadrit kombëtar për regjistrat statistikorë të ndërmarrjeve.

Pjesa B: Periudha e referencës dhe frekuenca

3. Regjistrat kombëtarë statistikore të ndërmarrjeve duhet të përditësohen të paktën një herë në vit përmes shtimit dhe heqjes së njësive.
4. Frekuenca e përditësimit do të varet nga lloji i njësisë, variabla që merret në konsideratë, madhësia e njësisë dhe burimi që përdoret përgjithësisht për përditësimin.
5. INSTAT duhet të bëjë çdo vit një kopje që pasqyron gjendjen e regjistrave kombëtarë statistikore të ndërmarrjeve në fund të vitit dhe ta ruajnë atë kopje për të paktën 30 vite për qëllime analizimi.

Regjistrat kombëtarë statistikorë të ndërmarrjeve duhet të përmbajnë , që për njësitë e përcaktuara në Artikullin 2 të kësaj Rregulloreje, të përmbaje tema të detajuara sipas njësisë.

Pjesa C: Temat e detajuara për regjistrat e biznesit

Njësitë	Tema e detajuar
1.Njësitë ligjore	Identifikimi (NIPT)
	Ngjarjet demografike
	Parametrat e stratifikimit
	Lidhja me ndërmarrjen

 REPUBLIKA E SHQIPËRISE
 INSTITUTI I STATISTIKAVE

	Lidhja me regjistra të tjerë
	Lidhja me grupet e ndërmarrjeve
	Kontrolli i njësive
	Pronësia e njësive ligjore
2.Grupet e ndërmarrjeve	Identifikimi
	Ngjarjet demografike
	Parametrat e stratifikimit dhe variablat ekonomike
3.Ndërmarrja	Identifikimi (NIPT)
	Lidhja me regjistra të tjerë
	Ngjarjet demografike
	Parametrat e stratifikimit dhe variablat ekonomike
4.Njësia lokale	Identifikimi
	Ngjarjet demografike
	Parametrat e stratifikimit dhe variablat ekonomike
	Lidhja me regjistra të tjerë
5.KAU nëse mbulohet si njësi statistikore	Identifikimi
	Ngjarjet demografike
	Parametrat e stratifikimit dhe variablat ekonomike
	Lidhja me njësi dhe regjistra të tjerë

Aneks IV:

Informacioni i siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në përputhje me Nenin 5(3):

(a) Të dhëna identifikuese mbi njësitë statistikore (persona juridikë dhe fizikë) që ushtrojnë veprimtari importi dhe eksporti të mallrave në Republikën e Shqipërisë, sipas procedurave doganore në fuqi;

(b) Të dhëna statistikore mbi tregtinë e jashtme të mallrave (importe dhe eksporte), të bazuara në deklaratat doganore të depozituara pranë administratës doganore, të pranuar ose të trajtuara me vendim administrativ nga autoritetet përkatëse.